



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

12

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr.Br.No.: **KGJK, nr.81/2017**

DAT.DT. **28 mars 2017**

QILISTINE 1

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1.8, 1.9, 1.10 dhe 1.15, 24 paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe nenit 4 të Rregullores mbi Organizmin e Brendshëm të Gjykatave, në mbledhjen e mbajtur me 28 mars 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNËS PËR VITIN 2016 TË GJYKATËS THEMELORE
NË GJILAN

1. Miratohen raporti i punës për vitin 2016 të Gjykatës Themelore në Gjilan;
2. Autorizohet Sekretariati i KGJK-së që të publikoj raportin në Ueb faqe të KGJK-së.

Nehat Idrizi,
Kryesues
Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së
- Arkivit të SKGJK



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

RAPORTI I GJYKATËS THEMELORE GJILAN

Gjatë muajve Janar – Dhjetor 2016 Gjykata Themelore e Gjilanit me degët e saj ka pasur për qëllim që të realizojë këto synime:

1. Caktimin e objektivave
2. Sfidat e paraqitura
3. Të arriturat

1. CAKTIMI I OBJEKTIVAVE

a) **Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre:** në Gjykatën Themelore të Gjilanit ishte tentuar që të bëhet në atë formë që gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda të kenë prej 100-120 lëndë, ndërsa gjyqtarët e departamenteve të përgjithshme të dhomës penale dhe civile të kenë prej 400-450 lëndë, ndërsa ata të kundërvajtjes të kenë afër 2000 lëndëve në punë me ngarkesë me lëndë gjatë vitit.

b) **Procedimi i lëndëve në kohë të arsyeshme:** që do të thotë se të gjitha lëndët iu është dhënë prioritet për një efikasitet më të lartë si dhe ato janë proceduar në një kohë të arsyeshme, me theks të veçantë, dhe lëndët e natyrave urgjente janë proceduar sipas dispozitave ligjore në fuqi, si dhe lëndëve të korrupsionit, dhe keqpërdorimi i detyrave zyrtare si dhe lëndët kundër të drejtave të votimit.

c) **Rritja e transparencës së gjykatës:** ishte si objektivë e gjykatës sonë që gjatë vitit 2016 të kontribuojnë edhe më tepër në rritje të transparencës me qytetarët, institucionet dhe me shoqërinë civile.

d) **Shfrytëzimi (përdorimi) i burimeve njerëzore dhe teknologjisë:** që disponon gjykata me degët e saja - i cili synim ka qenë që të sistemohen dhe shfrytëzohen kapacitetet e burimeve njerëzore, si dhe shfrytëzimi i teknologjisë që është për momentin që disponon Gjykata Themelore dhe degët e saj për përdorimin e teknologjisë të paraparë me planin e KGJK-së.

2. SFIDAT E PARAQITURA

Disa nga sfidat të cilat janë paraqitur gjatë muajve Janar - Dhjetor 2016 janë:

a) Numri i vogël i gjyqtarëve - Në gjithë regjionin me tri degët e saj, Gjykata Themelore disponon me 32 gjyqtarë me kryetarin e gjykatës.

b) Dega e Gjykatës Themelore në qytezën e Novobërdës - ku e njëjta degë është dashur të mbulohet me gjyqtarët e departamentit të përgjithshëm dhe atë gjyqtarë të lëmisë civile që për çdo javë nga një ditë trajtojnë nga një çështje të të njëjtës lëmi ndërsa për udhëheqës të degës në fillim është plotësuar nga departamenti i përgjithshëm e më pas nga dega e Kamenicës, për një periudhë kohore prej një viti. Kjo edhe më tepër e vështirëson mungesën e gjyqtarëve në këtë regjion.

c) Numri i lëndëve të cilat janë treguara si të kryera gjatë viteve raportuese 2011-2012 (me urdhra ndëshkimorë), të cilat lëndë janë kundërshtuar dhe janë në përfundim e sipër gjatë pjesës së parë të vitit 2015 e që kanë zbehur efikasitetin e punës së gjyqtarëve të departamentit të përgjithshëm.

d) Sfidë e radhës ishte mungesa e gjyqtarëve të departamentit përkatës - Krimeve të Rënda dhe Departamentin e Përgjithshëm, po ashtu për plotësim të numrit të gjyqtarëve është i nevojshëm edhe në Degët e Gjykatës Themelore Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, për formimin e kolegjeve penale, kur e dimë se për disa vepra penale të natyrës më të lehtë duhet të jetë paneli prej tre gjyqtarëve profesional.

e) Mos zbatimi i urdhëresave nga Policia e Kosovës dhe realizimi i tyre, si të lëndëve në procedurë penale si dhe lëndët e ekzekutimeve.

f) Numri i vogël i prokurorëve të cilët nuk kanë pasur mundësi për të përfaqësuar aktakuzat, sidomos mungesa e tyre dhe degët e kësaj gjykate ku në degën e Vitisë prokurorët përfaqësojnë lëndët pesë ditë në javë nga një prokuror, ndërsa në Kamenicë dy ditë dhe njëra me dy prokuror dhe një ditë me një prokuror dhe Artanë nga një ditë në javë, kur dihet se dy degët e Kamenicës janë 2 gjyqtarë të lëmisë penale si dhe 4 gjyqtarë në degën e Vitisë të të njëjtës lëmi. Për këtë janë njoftuar Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i shtetit.

Njoftoheni se ka filluar projekti përmes Zyrës Amerikane për caktimin e një gjyqtari dhe një prokurori për kohë të caktuar në përfaqësim të seancave gjyqësore veç po shihen rezultat.

g) Disa nga gjyqtarët - personeli administrativ të cilët janë në moshë të shtyrë dhe nuk mund të shfrytëzojnë teknologjinë që disponon gjykata me programet elektronike të menaxhimit të lëndëve.

h) Regjistrimi i lëndëve në mënyrë manuale dhe elektronike në departamentin e krimeve të rënda dhe departamentin e përgjithshëm, e vështirëson edhe më shumë punën e administratës së gjykatës.

i) Regjistrimi i lëndëve dy herë për të njëjtin kundërvajtës kur policia e Kosovës gjatë nëntë muajve të vitit 2015 janë deponuar në këtë divizion mbi 23869 lëndë dhe disa prej tyre është dashur të cedohen në Gjykatat Themelore tjera të Kosovës.

j) Ekzekutimi i lëndëve me dokument autentik, të cilat të gjitha kanë qenë të regjistruara, dhe një pjesë prej tyre nuk iu kanë dërguar propozimet kreditoreve dhe atë për një periudhë kohorë të gjatë dhe kemi një efikasitet në këtë lëmi.

k) Mungesa e teknologjisë - audio dhe video ingjizimet, dhe përkthimeve simultante kur dihet se gjykata disponon me 10 salla të gjykimit, ndërsa vetëm njëra prej tyre disponon këtë teknologji ndërsa sallat e gjykimeve nëpër degë nuk disponojnë këtë teknologji.

l) Vonesa në plotësimin e vendeve të lira të punës për gjyqtarët dhe stafin administrativë, për shkakë objektive ku dihet se një pjesë prej tyre janë pensionuar dhe në vitet në vijim pritet të shkojnë dhe një numër i konsiderueshëm .

m) Sfidë e radhës ishte dhe regjistrimi i lëndëve të vjetra para viti 1999 asgjësimi dhe arkivimi i tyre.

3. TE ARRITURAT

Disa nga të arriturat gjatë muajve Janar – Dhjetor 2016 janë:

Gjykata Themelore Gjilan 2016	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të vitit 2016	Lëndët e ardhura në 2016	Gjithsejtë lëndët në punë në 2016	Lëndët e kryera gjatë në 2016	Lëndët e mbetura në 2016	Përqindja e lëndëve të zgjidhura gjatë 2016
		I	II	III	IV	V	II – IV %
Dep. Krimeve të Rënda	Penale	524	326	850	470	380	144 %
	Ankesat në Aktvendimin për paraburgim	7	74	81	71	10	95 %
Dep. Përgjithshëm	Penale	2260	1516	3776	1284	2492	84 %
	Paraprake	61	501	562	440	122	87
	Ekzekutime penale	1844	813	2657	1167	1490	143 %
	Civile	2325	979	3304	996	2308	101 %
	Përmbartimi i dokumentit autentik	2812	25	2837	1699	1138	6796 %
	Përmbartimi i vendimit përmbartues	343	10	353	78	275	780 %
	Jashtëkontestimore	239	293	532	269	263	91 %
	Trashëgimore	41	15	56	42	14	280 %
Dep. për të Mitur	Penale para kolegjit	96	178	274	174	100	97 %
	Përgatitore për të mitur	1	236	237	228	9	96 %
Dep. Kundërvajtjes	Kundërvajtje	2219	23869	26088	26038	50	109 %
	TOTALI	12772	28835	41607	32956	8651	114 %

Dega e Thelores Kamenicë 2016	Lëmia	Lëndët e trashëguar a në fillim të vitit 2016 I	Lëndët e ardhura në 2016 II	Gjithsejtë lëndët në punë në 2016 III	Lëndët e kryera në 2016 IV	Lëndët e mbetura në 2016 V	Përqindja e lëndëve të zgjdhura gjatë 2016 II – IV %
Dep. Përgjithshëm	Ankesat në Aktvendimin paraburgim për	0	22	22	22	0	100 %
	Penale	788	400	1188	415	773	103 %
	Procedurë paraprake	0	25	25	25	0	100 %
	Ekzekutime penale	339	240	579	445	134	185 %
	Civile	372	285	657	202	455	70 %
	Përmbarimi i dokumentit autentik	375	24	399	230	169	958 %
	Përmbarimi i dokumentit përmbarues	106	1	107	27	80	2700 %
	Trashëgimore	27	7	34	4	30	57 %
Dep. Kundërvajtjes	Kundërvajtje	3274	5220	8494	5238	3256	100 %
TOTALI		5302	6246	11548	6630	4918	106 %

Dega e Themelores Viti 2016	Lëmia	Lëndët e trashëguar a në fillim të vitit 2016 I	Lëndët e ardhura në 2016 II	Gjithsejtë lëndët në punë në 2016 III	Lëndët e kryera në 2016 IV	Lëndët e mbetura në 2016 V	Përqindja e lëndëve të zgjidhura në 2016 II – IV %
Dep. Përgjithshëm	Ankesat në Aktvendimin paraburgim për	0	7	7	7	0	100 %
	Penale	1346	653	2089	849	1240	130 %
	Procedurë paraprake	9	19	28	24	4	126 %
	Ekzekutime penale	618	379	997	448	549	103 %
	Civile	1265	481	1746	497	1249	105 %
	Përmbarimi i dokumentit autentik	1317	44	1361	371	990	843 %
	Përmbarimi i dokumentit përmbarues	187	12	199	36	163	300 %
	Jashtëkontestimore	35	32	67	34	33	106 %
	Trashëgimore	10	38	48	32	16	84 %
Dep. Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1926	8832	10758	9282	1476	105 %
TOTALI		6803	10497	17300	11580	5720	110 %

Dega e Themelores Novobërdë 2016	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të vitit 2016 I	Lëndët e ardhura në 2016 II	Gjithsejtë lëndët në punë në 2016 III	Lëndët e kryera në 2016 IV	Lëndët e mbetura në 2016 V	Përqindja e lëndëve të zgjidhura në 2016 II – IV %
Dep. Përgjithshëm	Ankesat në për Aktvendimin paraburgim	1	0	1	0	1	%
	Penale	7	90	167	67	100	74 %
	Paraprake	3	8	11	6	5	75 %
	Ekzekutime penale	81	23	104	44	60	191 %
	Civile	123	69	192	22	170	31 %
	Përmbartimi i dokumentit autentik	50	2	52	14	38	700 %
	Përmbartimi i dokumentit përmbartues	7	0	7	4	3	%
	Jashtëkontestimore	8	6	14	3	11	50 %
	Trashëgimore	8	8	16	2	14	25 %
Dep. Kundërvajtjes	Kundërvajtje	649	1013	1662	960	702	94 %
TOTALI		1007	1219	2226	1122	1104	92 %

A) Ekzekutimi i vendimeve sipas dokumenteve autentike dhe dërgimi i propozimeve kreditore, si dhe bllokimi i xhirollogarive të kreditorëve, pezullimi dhe kryerja e një numri të konsiderueshëm të tyre,

B) Lëndët e treguara gjatë vitit 2011-2012, sipas urdhrorit ndëshkues dhe të departamentit për të mitur janë në përfundim e sipër.

C) Regjistrimi dhe përgatitja për asgjësimin i lëndëve të Divizionit Kundërvajtës për vitin 2008-2009.

D) Vazhdimi i trajnimit të gjyqtarëve dhe stafit administrativ për shfrytëzimin e teknologjisë- programeve elektronike.

E) Rritja e transparencës së gjykatës në raport me qytetarët, dhe caktimi i zëdhënësit të gjykatës duke kontribuar në rritjen e transparencës si dhe shërbimet e bëra nga punëtorët e autorizuar në sportelet e gjykatës, duke i njoftuar ata dhe për mbajtjen e gjykimeve në formën elektronike dhe manuale.

F) Vjelja e taksave gjyqësore dhe dënimeve në Gjykatën Themelore Gjilanit së bashku me Degët për muajt Janar – Dhjetor janë:

- | | |
|----------------------------|------------------------|
| • Gjykata Themelore Gjilan | 720.782.01 Euro |
| • Dega Kamenicë | 269.353,39 Euro |
| • Dega Viti | 683.629,79 Euro |
| • Dega Novobërdë | 28.510,00 Euro |

Gjithsej

1.702.275,19 Euro

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Mr.sc. Zyhdi Haziri



Data: 31.12.2016